



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KOMISIONI

Nr. 6083 prot.

Ballsh, më 15.12. 2025

NJOFTIM

Në bazë të Ligjit nr. 139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vëndore”, VKM-së Nr.179, datë 26.02.2020 “Për rregullat, kushtet dhe procedurat e privatizimit të banesave që kanë qenë subjekt i Ligjit Nr.7652, datë 23.12.1992 “Për privatizimin e banesave shtetërore”, dhe i Ligjit Nr.9321, datë 25.11.2004 “Për privatizimin e banesave dhe objekteve të kthyer në banesa të ndërtuara me fondet e shoqërive dhe të ndërmarrjeve shtetërore”, Vendimit të Këshillit Bashkiak Mallakastër Nr. 42, datë 21.11.2025 “Për miratimin e fillimit të procedurave të privatizimit të pasurisë me Nr. 3/70+1-16, apartament, ZK 1090, lagjja “18 prilli”, Ballsh, Bashkia Mallakastër”, si dhe Urdhërit të kryetarit të Bashkisë Mallakastër Nr. 310, datë 24.10.2025 “Ngritjen e komisionit për vazhdimin e procedurave për privatizimin e banesave dhe të objekteve të kthyer në fond banesë të paprivatizuara në territorin e Bashkisë Mallakastër”,

1. Njoftohen qytetarët të cilët posedojnë banesa ose objekte të kthyer në banesa të ndërtuara nga shteti, të cilat vijnë të jenë në pronësi të shtetit, të ndodhura në pasurinë me Nr. 3/70+1-16 pasurie, ZK 1090 të paraqesin brenda 60 ditëve nga kërkesën për fillimin e procedurave të privatizimit të banesave pranë Bashkisë Mallakastër.
2. Kërkesa duhet të paraqitet nga
 - 2.1- Subjekti i pajisur me autorizim nga organet kompetente, ose në rast vdekjeje të trashëgimtarëve të tij;
 - 2.2- Çdo person i autorizuar me prokurë nga subjekti i përcaktuar më lart.
3. Kërkesa duhet të përmbajë :
 - 3.1- Të dhënat personale të subjektit kërkues
 - 3.2- Të dhënat lidhur me banesën ose objektin e kthyer në banesë
 - 3.3- Datën e kërkesës dhe nënshkrimin e kërkuesit
4. Kërkesa duhet të shoqërohet me dokumentacionin e mëposhtëm:
 - 4.1- Kontrata e qirasë, akti i dhënies dhe i marrjes në dorëzim të banesës nga ish-ndërmarrja komunale banesa, ose autorizim nga ish-organet administrative publike që e kanë strehuar në atë banesë
 - 4.2- Çertifikatë familjare e datës 1.12.1992 dhe çertifikatë aktuale familjare
 - 4.3- Dëshmi e trashëgimisë, nëse ka ndërruar jetë subjekti i pajisur me autorizim

- 4.4- Prokurë nëse personi është ngarkuar për të kryer veprimet nga subjekti i pajisur me autorizim
 - 4.5- Dokument identifikimi i kërkuarit
5. Subjekti humbet të drejtën për të kërkuar privatizimin e banesës, në të cilën është strehuar, kur:
- 5.1- Nuk depoziton kërkesën
 - 5.2- Nuk depoziton dokumentacionin e përcaktuar
 - 5.3- Refuzon që të paguajë vlerën e privatizimit të banesës

KRYETAR
Qerim Ismailaj

